VENDIM
Nr. 153, datë 21.10.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ELECTRAL BATRA HPP" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "e"; 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95/2 prot, datë 18.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511 prot, datë 13.8.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 131, datë 29.8.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/38 prot, datë 30.8.2019, si dhe me shkresën nr. 515/1 prot, datë 30.8.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

-Shoqëria ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511/3 prot, datë 16.9.2019 dhe nr. 511/4 prot, datë 7.10.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti